



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Kuvendi

PROJEKT LIGJ

Nr. _____/2016

PËR

SHËRBIMET NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË¹

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

V E N D O S I:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi i ligjit

Ky ligj ka për qëllim të përcaktojë parimet themelore dhe kriteret që garantojnë të drejtën e themelimit dhe të drejtën e ushtrimit të aktivitetit për ofruesit e shërbimeve në Republikën e Shqipërisë, duke garantuar cilësi të lartë të shërbimeve për përfituesit e tyre.

Neni 2
Fusha e veprimit

1. Ky ligj zbatohet për të gjitha shërbimet e ofruara në Republikën e Shqipërisë, me përjashtim të:
 - a) shërbimeve joekonomike, me interes të përgjithshëm;

¹ Ky ligj është përafuar pjesërisht me Direktivën 2006/123/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 12 dhjetor 2006 "Për shërbimet në tregun e brendshëm" Celex : 32006L0123, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, Seria L 376/36, datë 27.12.2006, f 1-33

- b) shërbimeve financiare, si shërbimet bankare, kreditimi, sigurimi e risigurimi, pensionet profesionale e personale, letrat me vlerë, fondet e investimeve, pagesat dhe këshillimi për investimet;
- c) shërbimeve e rrjeteve të komunikimit elektronik, si dhe objekteve të lidhura me to, në lidhje me çështjet që mbulon ligji për komunikimet elektronike;
- ç) shërbimeve në fushën e transportit, përfshirë transportin rrugor, hekurudhor, detar dhe ajror;
- d) shërbimeve të agjencive të punësimit të përkohshëm;
- dh) shërbimeve shëndetësore e farmaceutike, të ofruara me qëllim terapeutik, nëpërmjet strukturave të kujdesit shëndetësor apo jo, dhe pavarësisht mënyrës së organizimit e financimit të tyre apo faktit nëse janë publike apo private;
- e) shërbimeve audiovizive, përfshirë edhe shërbimet kinematografike, pavarësisht mënyrës së prodhimit, shpërndarjes e transmetimit, si edhe transmetimet radiofonike e çdo shërbim tjetër, që jepet në fushën e të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to, në bazë të legjislacionit që rregullon këtë veprimtari në vendin tonë;
- ë) lojërave të fatit;
- f) veprimtarive që lidhen me ushtrimin e autoritetit zyrtar;
- g) shërbimeve sociale që u ofrohen individëve dhe grupeve në nevojë, të cilët nuk janë në gjendje të përballojnë, me burimet që kanë, nevojat e tyre jetësore për ruajtjen, zhvillimin dhe rehabilitimin e mundësive individuale, për të kapërcyer nevojat emergjente ose kronike, të ofruara nga shteti ose subjekte jopublike, të licencuara nga shteti;
- gj) strehimit social;
- h) tatimeve, taksave kombëtare ose vendore;
- i) shërbimeve private të sigurisë fizike;
- j) shërbimeve të ofruara nga noterët apo përmbauesit, të emëruar me një dokument zyrtar të qeverisë.

Neni 3 **Përkufizime**

Në këtë ligj, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Shërbim”, çdo veprimtari ekonomike, e kryer nëpërmjet vetëpunësimit kundrejt një shpërblimi, si edhe çdo lloj veprimtarie me karakter intelektual, e zhvilluar në formën e sipërmarrjes apo në atë profesionale, në mënyrë të pavarur dhe kundrejt një shpërblimi;
2. “Ofrues”, çdo person fizik apo juridik, i regjistruar në Republikën e Shqipërisë në përputhje me legjislacionin në fuqi, i cili ofron apo realizon një shërbim;

3. “Përfitues/marrës shërbimi”, çdo person fizik dhe juridik, shtetas shqiptar apo i huaj, i cili, për qëllime profesionale apo jo, përdor apo dëshiron të përdorë një shërbim;
4. “Themelim dhe ushtrim i aktivitetit”, ushtrimi efektiv/faktik i një veprimtarie ekonomike nga ofruesi i shërbimit, për një periudhë të pacaktuar dhe nëpërmjet një selie të përhershme në Republikën e Shqipërisë;
5. “Skemë autorizimi”, çdo procedurë apo akt administrativ, në bazë të së cilës një autoritet kompetent i jep ofruesit ose përfituesit të një shërbimi një vendim zyrtar ose të nënkuptuar për ofrimin e një shërbimi, apo aksesin në një veprimtari shërbimi;
Në kuptim të këtij ligji, termat licencë, leje, autorizim, certifikatë, pëlqim, regjistrim pranë ndonjë urdhri apo organizate profesionale, njoftim si edhe çdo term tjetër i ngjashëm me to në legjislacionin shqiptar në fuqi, nëpërmjet të cilit lejohet ose kufizohet ushtrimi i një aktiviteti apo ofrimi i një shërbimi, do të konsiderohen si skemë autorizimi.
6. “Kriter”, çdo detyrim, ndalim, kusht apo kufizim, i parashikuar në legjislacionin sektorial; Rregullat e parashikuara në kontratat kolektive të punës nuk konsiderohen si kritere, sipas kuptimit të këtij ligji;
7. “Arsye madhore të lidhura me interesin publik”, politika publike, sigurimi/mbrojtja publike, siguria publike, shëndeti publik, ruajtja e ekuilibrit financiar të sistemit të sigurimeve shoqërore, mbrojtja e konsumatorëve, përfituesve të shërbimeve dhe punonjësve, korrektësia/drejtësia në transksionet tregtare, lufta ndaj mashtrimeve tregtare/krimin ekonomik, mbrojtja e mjedisit dhe e ambientit qytetës, shëndeti i kafshëve, pronësia intelektuale, ruajtja e trashëgimisë historike e kulturore kombëtare, objektivat e politikës sociale dhe objektivat e politikës kulturore;
8. “Autoritet kompetent”, çdo organ ose autoritet që ka rol mbikëqyrës apo rregullator në një veprimtari shërbimi, në mënyrë të veçantë organet administrative, përfshirë gjykatat administrative, organet profesionale dhe shoqatat apo organizata të tjera profesionale, të cilat rregullojnë, në mënyrë kolektive, ofrimin/përfitimin e një shërbimi apo ushtrimin e veprimeve të tjera të lidhura me të;
9. “Profesion i rregulluar”, çdo veprimtari profesionale apo grup veprimtarish profesionale, sipas përcaktimeve të bëra në legjislacionin shqiptar në fuqi mbi profesionet e rregulluara;
10. “Komunikim tregtar”, çdo formë komunikimi e drejtpërdrejtë apo e tërthortë, që ka për qëllim të promovojë mallrat, shërbimet apo imazhin e një sipërmarrjeje, organizate ose personi të angazhuar në një veprimtari tregtare, industriale, zejtare/zanati apo në ushtrimin e një profesioni të rregulluar. Nuk përbëjnë komunikim tregtar, në kuptim të këtij ligji,:

- a) informacioni që mundëson aksesin e drejtpërdrejtë në veprimtarinë e një sipërmarrjeje, organizate apo personi, si emri i domainit në internet apo adresa e postës elektronike;
 - b) komunikimi lidhur me mallrat, shërbimet, imazhin e një sipërmarrjeje, organizate apo personi, i ofruar në mënyrë të pavarur dhe pa kundërshpërblim.
11. “Ministria”, ministria që mbulon çështjet e tregtisë;
 12. “Legjislacion sektorial”, legjislacioni, duke përfshirë ligje, vendime, rregullore, udhëzime dhe çdo akt tjetër ligjor apo nënligjor, si dhe rregullat e parashikuara sipas akteve të urdhrave apo organizatave profesionale, që rregullojnë ushtrimin e veprimtarive në një sektor të caktuar;
 13. “Autoriteti përgjegjës”, autoriteti që mbulon çështjet dhe harton politikat e nevojshme për një sektor të caktuar;
 14. “Shërbime ekonomike me interes të përgjithshëm”, shërbimet me interes të përgjithshëm, që ofrohen kundrejt një shpërblimi;
 15. “Shërbime joekonomike me interes të përgjithshëm”. shërbimet me interes të përgjithshëm, që ofrohen pa shpërblim.

KREU II

E DREJTA E THEMELIMIT DHE SKEMAT E AUTORIZIMIT

Seksioni 1

E drejta e themelimit

Neni 4

Parime të përgjithshme

Ushtrimi i veprimtarisë së shërbimit, në territorin e Republikës së Shqipërisë, nga persona fizikë ose juridikë, duhet të përmbushë këto kritere:

- a) Të mos kushtëzohet nga kritere diskriminuese;
- b) Nëse kufizohet, duhet të burojë vetëm nga një arsye madhore, që lidhet me interesin publik;
- c) Kufizimet, sipas shkronjës “b”, të këtij neni, në rast se ka të tilla, duhet të jenë të tilla që të sigurojnë përmbushjen e qëllimit të përcaktuar, i cili është i pamundur të përmbushet në mungesë të këtyre kufizimeve, dhe të mos shkojnë përtej asaj që është e nevojshme për arritjen e këtij qëllimi.

Neni 5

Kriteret e ndaluara

Ushtrimi i veprimtarisë për ofrimin e një shërbimi në territorin e Republikës së Shqipërisë, nga persona fizikë ose juridikë, të regjistruar sipas legjislacionit në fuqi, nuk mund të kushtëzohet, në asnjë rast, nga:

1. zbatimi i kriterëve diskriminuesë, që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me shtetësinë apo, në rastin e shoqërive tregtare, me vendndodhjen e selisë, përfshirë, në mënyrë të veçantë,:
 - i. kriterë që ofruesi i shërbimit, personeli i tij, aksionarët, ortakët ose anëtarët e këshillit të administrimit apo të këshillit mbikëqyrës të jenë shtetas shqiptarë;
 - ii. kriterë që ofruesi i shërbimit, personeli i tij, aksionarët, ortakët ose anëtarët e këshillit të administrimit apo të këshillit mbikëqyrës të jenë të pajisur me leje qëndrimi, sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.
2. kërkesa për paraqitjen, rast pas rasti, të testit ekonomik, nga ofruesi i shërbimit, si kusht për pajisjen me autorizim, për të vërtetuar një nevojë ekonomike apo kërkesë të tregut, për të vlerësuar efektet ekonomike të mundshme apo faktike të veprimtarisë si dhe për të vlerësuar përshtatshmërinë e veprimtarisë, në lidhje me objektivat e planifikimit ekonomik, të përcaktuara nga autoriteti kompetent;
3. përfshirja, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, e subjekteve konkurrencte në dhënien e autorizimeve, përfshirë edhe pjesëmarrjen e tyre në organizmat konsultative, me përjashtim të organizatave dhe shoqatave profesionale apo organizatave të tjera, që veprojnë si autoritet kompetent. Ky ndalim nuk ka të bëjë me konsultimin e organizatave, të tilla si dhomat e tregtisë apo shoqatat e biznesit, për çështje që nuk kanë lidhje me aplikime specifike për autorizim ose konsultimin e publikut.
4. detyrimi për të dhënë apo për të qenë pjesë e një garancie financiare ose për t'u siguruar nga një ofrues apo organizëm i vendosur në territorin e tyre. Kjo dispozitë nuk kufizon të drejtën e autoriteteve kompetente për të kërkuar sigurimin ose një garanci financiare vetëm në rastet e një arsyeje madhore, që lidhet me një interes publik.
5. detyrimi që të kenë qenë të regjistruar, për një periudhë të caktuar, në regjistrat e mbajtur në vendin e tyre, ose të kenë ushtruar, më parë, veprimtarinë në territorin e tyre.

Neni 6

Kriterë që duhen vlerësuar

1. Kriteret e përcaktuara në pikën 2, të këtij neni, duhet të respektojnë, në të gjitha rastet, parimet e parashikuara në nenin 4, të këtij ligji. Autoritetet

përgjegjëse duhet të vlerësojnë, rast pas rasti, nëse legjislacioni i ri sektorial respekton përcaktimet e këtij ligji.

2. Kriteret që duhet të vlerësohen, nëse janë të domosdoshme, janë:

- a) kufizimet sasiore apo territoriale, veçanërisht në formën e një numri të caktuar popullsie apo distance minimale ndërmjet ofruesve të shërbimit;
- b) detyrimi i ofruesit për të patur një formë të caktuar juridike;
- c) kërkesa që lidhen me zotërimin e kuotave ose aksioneve të një shoqërie;
- ç) kërkesa, sipas të cilave e drejta e ofrimit të një shërbimi të caktuar, përjashtuar profesionet e rregulluara, për shkak të natyrës specifike të veprimtarisë, u jepet ofruesve të caktuar;
- d) ndalimi për të patur më shumë se një zyrë brenda territorit;
- dh) kërkesa për të patur një numër minimal punonjësish;
- e) vendosja e tarifave minimale dhe/ose maksimale, të cilave duhet t'u përmbahet ofruesi i shërbimit;
- ë) detyrimi ndaj një ofruesi që, bashkë me shërbimin e tij, të ofrojë edhe shërbime të tjera specifike.

3. Autoritetet përgjegjëse duhet të njoftojnë, pranë Ministrisë, legjislacionin e ri sektorial, që propozon parashikimin e kriterëve të përcaktuara në pikën 1, së bashku me arsyetimin përkatës për parashikimin e këtyre kriterëve. Ministria do të shqyrtojë përputhshmërinë e tij me këtë ligj dhe, sipas rastit, do t'i rekomandojë autoritetit përgjegjës nëse kriteri nuk duhet miratuar apo duhet shfuqizuar. Procedura e njoftimit dhe forma e vlerësimit të përputhshmërisë së legjislacionit të ri sektorial përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, të nxjerrë në zbatim të këtij ligji.

Seksioni 2

Skemat e autorizimit

Neni 7

Parime të përgjithshme

- 1. Ushtrimi i veprimtarisë për ofrimin e një shërbimi në territorin e Republikës së Shqipërisë mund të kushtëzohet nga pajisja me një skemë autorizimi vetëm nëse respektohen parimet e përcaktuara në nenin 4, të këtij ligji.
- 2. Pajisja me një skemë autorizimi i jep të drejtë ofruesit të një shërbimi për të ushtruar veprimtarinë e tij në të gjithë territorin, me përjashtim të rasteve

kur, për shkak të një arsyeje madhore, të lidhur me interesin publik, skema e autorizimit është e vlefshme për një vendndodhje të caktuar të territorit.

3. Skemat e autorizimit jepen pa një afat kohor të përcaktuar, përveç rasteve kur:
 - a) ajo rinovohet automatikisht ose i nënshtrohet përmbushjes së vazhdueshme të kërkesave ligjore;
 - b) numri i tyre në dispozicion është i kufizuar, për arsye madhore, që lidhen me interesin publik;
 - c) vlefshmëria e kufizuar e saj justifikohet nga një arsye madhore, që lidhet me interesin publik.
4. Pavarësisht sa parashikohet në pikën 3, të këtij neni, autoritetet kompetente mund të parashikojnë një afat kohor të caktuar për një skemë autorizimi, brenda të cilit ofruesi duhet të fillojë, efektivisht, veprimtarinë e tij.
5. Në rastin e mungesës së burimeve natyrore të mjaftueshme apo nevojës për aftësi teknike, numri i skemave të autorizimit në dispozicion, për një aktivitet të caktuar, mund të kufizohet. Në këto raste, skema e autorizimit do të jepet për një përudhë të caktuar dhe mund të mos ketë rinovim automatik.

Neni 8

Kushtet për miratimin e skemave të autorizimit

1. Kriteret e çdo skeme autorizimi duhet të jenë në përputhje me parimet e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative.
2. Procedurat për pajisjen me një skemë autorizimi duhet të plotësojnë këto kushte:
 - a) Të jenë të qarta, transparente, të bëra publike paraprakisht dhe të garantojnë objektivitetin e paanësinë e autoriteteve kompetente gjatë shqyrtimit të kërkesave;
 - b) Të jenë lehtësisht të aksesueshme, të thjeshta dhe të mos shkaktojnë vonesa të panevojshme në ofrimin e shërbimit;
 - c) Të trajtohen brenda një afati të arsyeshëm, të përcaktuar dhe të bërë publik paraprakisht. Ky afat fillon në momentin e dorëzimit të të gjithë dokumentacionit të nevojshëm. Në rastet e çështjeve të komplikuar, ky afat mund të shtyhet vetëm një herë, për një kohë të caktuar. Shtyrja e afatit dhe kohëzgjatja e tij duhet të jetë i motivuar dhe t'i njoftohet kërkuarit para mbarimit të afatit të mëparshëm.

- ç) Një skemë autorizimi konsiderohet e miratuar në heshtje, në përputhje me parimet e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative;
 - d) Çdo pagesë për pajisjen me një skemë autorizimi duhet të jetë e arsyeshme, në proporcion me koston e procedurave, dhe të mos e kalojë koston administrative për shërbimin;
 - dh) Të kenë të përcaktuara procedurat e ankimimit;
 - e) Në rastet kur kërkesa është e paplotë, autoritetet kompetente duhet të njoftojnë kërkuarit për dorëzimin e dokumenteve shtesë të nevojshme si edhe për efektet në lidhje me shqyrtimin, sipas shkronjës “c”, më sipër;
 - ë) Në rast refuzimi të kërkesës, për shkak të mospërbushjes së procedurave të mësipërme, kërkuari duhet të njoftohet, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
4. Çdo vendim i autoriteteve kompetente, përfshirë refuzimin apo anulimin e një skeme autorizimi, duhet të jetë i arsyetuar. Ky vendim mund të ankimohet, në përputhje me procedurat e ankimimit administrativ, të parashikuara në legjislacionin në fuqi.

Neni 9

Procedurat përzgjedhëse

1. Në rastet kur numri i skemave autorizuese në dispozicion është i kufizuar, siç parashikohet në pikën 5, të nenit 7, të këtij ligji, zhvillohet një procedurë përzgjedhëse ndërmjet kandidatëve të mundshëm.
2. Procedura e parashikuar sipas pikës 1, të këtij neni, duhet të jetë e paanshme, transparente dhe të bëhet publike në të gjitha fazat e procesit përzgjedhës.
3. Në rastet e parashikuara në pikën 1, të këtij neni, kohëzgjatja e skemës së autorizimit mund të jetë e kufizuar në kohë dhe e parinovueshme automatikisht.
4. Për përcaktimin e rregullave për procedurat përzgjedhëse duhet të merren parasysh të gjitha kriteret që lidhen me interesin publik.

KREU III

PIKA E VETME E KONTAKTIT

Neni 10

Krijimi i Pikës së Vetme të Kontaktit (PVK)

1. Pika e Vetme e Kontaktit (PVK) është një portal elektronik, nëpërmjet të cilit ofruesit e shërbimeve mund të kryejnë procedurat:
 - a) për fillimin e veprimtarisë së tyre, lidhur me deklaratimet, njoftimet apo kërkesat e nevojshme për pajisje me skemë autorizimi nga autoritetet kompetente, përfshirë edhe aplikimin, regjistrimin në një regjistër, listë apo bazë të dhënash, ose për regjistrimin pranë një organi apo organizate profesionale;
 - b) për çdo aplikim për pajisjen me autorizimin e nevojshëm për ushtrimin e veprimtarisë së tij të shërbimit.
2. PVK-ja nuk cënon, aspak, kompetencat dhe funksionet e autoriteteve kompetente për kryerjen e këtyre procedurave, të parashikuara me ligj.
3. PVK-ja është pjesë e portalit *e-Albania* dhe administrohet nga autoritetet kompetente për këtë portal, si edhe autoritetet e tjera kompetente përgjegjëse, sipas fushave. Mënyra e funksionimit të PVK-së miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 11

Përmbajtja e Pikës së Vetme të Kontaktit (PVK)

1. Nëpërmjet PVK-së, ofruesve dhe përfituesve të shërbimeve u sigurohet i gjithë informacioni i nevojshëm për:
 - a) kërkesat, në lidhje me procedurat dhe formalitetet që duhen plotësuar për fillimin dhe ushtrimin e veprimtarisë;
 - b) kontaktet e autoriteteve kompetente, që kanë të bëjnë me ushtrimin e veprimtarive të shërbimeve;
 - c) mjetet dhe kushtet për hyrjen në regjistrat publikë e në bazat e të dhënave për ofruesit dhe shërbimet;
 - ç) mjetet e ankimit në dispozicion, në rast të mosmarrëveshjeve ndërmjet autoriteteve kompetente dhe ofruesit apo përfituesit të shërbimit, ndërmjet një ofruesi dhe një përfituesi, apo ndërmjet ofruesve;
 - d) kontaktet e shoqatave apo organizatave, të ndryshme nga autoritetet kompetente, të cilat mund të ndihmojnë ofruesit apo përfituesit.
2. Informacioni, i parashikuar sipas pikës 1, duhet të jetë lehtësisht i aksesueshëm në mënyrë elektronike dhe të jetë i përditësuar, në gjuhën shqipe dhe angleze.
3. PVK-ja dhe autoritetet kompetente duhet të përgjigjen, në përputhje me afatet e përcaktuara në Kodin e Procedurës Administrative, ndaj çdo

kërkese për informacion apo ndihme, sipas pikave 1 e 2, të këtij neni, dhe, në rastet kur kjo kërkesë ka të meta apo është e pabazuar, të informojnë kërkuesin.

4. Detyrimi i autoriteteve kompetente për të ndihmuar ofruesit dhe përfituesit e shërbimeve nuk nënkupton ofrimin e këshillimit ligjor për çështje të caktuara, por vetëm dhënien e informacionit të përgjithshëm për mënyrën e interpretimit dhe të zbatimit të kërkesave ligjore.

Neni 12

Procedurat në mënyrë elektronike

1. Të gjitha procedurat dhe formalitetet që lidhen me aksesin në një veprimtari shërbimi apo ushtrimin e saj mund të kryhen edhe në mënyrë elektronike, nëpërmjet PVK-së, dhe pranë autoriteteve kompetente përkatëse.
2. Nuk zbatohet, sa parashikohet në pikën 1, të këtij neni, në rastin e inspektimit të ambienteve ku ofrohet shërbimi dhe të pajisjeve të përdorura për këtë qëllim apo për këqyrjen fizike të aftësive të ofruesit ose të personelit të tij përgjegjës.

KREU IV

TË DREJTAT E PËRFITUESVE DHE CILËSIA E SHËRBIMEVE

Neni 13

Të drejtat e përfituesve të shërbimeve

1. Çdo person fizik, shqiptar apo i huaj, mund të përfitojë nga shërbimet e ofruara në territorin e Republikës së Shqipërisë pa qenë i detyruar të pajiset me një autorizim apo të bëjë deklaratë para autoriteteve kompetente për këtë qëllim.
2. Kushtet e përgjithshme për përfitimin e një shërbimi të caktuar, të bëra publike nga ofruesi, nuk mund të përmbajnë kritere diskriminuese, lidhur me shtetësinë apo vendin e qëndrimit të përfituesit. Ndryshimet, në kushtet për përfitimin nga shërbimi, janë të mundshme kur justifikohen nga kritere objektive.
3. Përfituesit e shërbimeve kanë të drejtë të kërkojnë dhe të marrin:

- a) informacion të përgjithshëm për kërkesat e zbatueshme për ushtrimin e veprimtarisë së ofrimit të shërbimeve e përfitimin prej tyre dhe, sidomos, për ato që lidhen me mbrojtjen e konsumatorëve;
- b) informacion të përgjithshëm për mjetet e ankimit, në rast mosmarrëveshjeje ndërmjet ofruesit dhe përfituesit;
- c) pikat e kontaktit të shoqatave apo organizatave, nga të cilat mund të informohen ofruesit apo përfituesit.

Informacioni dhe ndihma e mësipërme duhet të jetë lehtësisht i aksesueshëm në mënyrë elektronike dhe i përditësuar.

Neni 14

Informacion për ofruesit dhe shërbimet e tyre

1. Ofruesit e shërbimeve duhet të venë në dispozicion të përfituesve informacionin, si më poshtë vijon:
 - a) Emrin, statusin dhe formën juridike të ofruesit, adresën, ku të jenë përcaktuar edhe të dhëna për kontaktim e komunikim të drejtpërdrejtë, sipas rastit, edhe në mënyrë elektronike;
 - b) Numrin unik të identifikimit të subjektit (NUIS);
 - c) Në rastin kur veprimtaria është objekt i autorizimit, të dhëna për autoritetin kompetent për këtë qëllim apo PVK-në;
 - ç) Në rastin e profesioneve të rregulluara, organin profesional apo ndonjë institucion të ngjashëm, ku ofruesi është regjistruar, titullin profesional dhe vendin ku e ka fituar këtë titull;
 - d) Kushtet dhe klauzolat e përgjithshme, nëse ka, që përdor ofruesi;
 - dh) Klauzolat kontraktore, nëse ka, të përdoruara nga ofruesi, në lidhje me dispozitat e zbatueshme dhe/ose gjykatat kompetente;
 - e) Garancitë pas shitjes, nëse ka;
 - ë) Çmimin e shërbimit, kur, për një shërbim të caktuar, është paracaktuar një çmim;
 - f) Karakteristikat kryesore të shërbimit, nëse nuk janë të qarta nga konteksti.

2. Informacioni i parashikuar në pikën 1, më sipër, duhet të sigurohet nga ofruesi në një nga këto mënyra:
 - a) Të jepet nga ofruesi me nismën e vet;
 - b) T'i vihet në dispozicion përfituesit në vendin e ofrimit të shërbimit apo ku lidhet kontrata;
 - c) T'i vihet në dispozicion përfituesit në mënyrë elektronike, nëpërmjet një adrese të vendosur nga ofruesi;

- ç) Të përfshihet në dokumentet informative, ku jepet një përshkrim i detajuar i shërbimit që ofrohet dhe që i jepet përfituesit nga ofruesi.
3. Me kërkesë të përfituesve, ofruesit duhet të paraqesin informacionin e mëposhtëm shtesë:
- a) Çmimin, në rastet kur, për një shërbim të caktuar, ky nuk është paracaktuar, ose, kur një çmim i saktë nuk mund të jepet, mënyrën e përlllogaritjes së tij apo një vlerë të përafërt të detajuar;
 - b) Rregullat profesionale të zbatueshme, sa u takon profesioneve të rregulluara, dhe ku gjenden ato;
 - c) Informacion për veprimtaritë e tjera apo partneritetet, të cilat lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me shërbimin e ofruar, dhe masat e marra për të shmangur konfliktin e interesit. Ky informacion duhet të përfshihet në çdo dokument informues, ku ofruesi jep një përshkrim të detajuar të shërbimit të tij.
 - ç) Kodin e etikës, mbi të cilin mbështetet ofruesi, si dhe adresën në të cilat këto kode mund të konsultohen, në mënyrë elektronike, me treguesin e versioneve gjyqësore të mundshme, nëse ka;
 - d) Në rastet kur ofruesi është anëtar i ndonjë shoqate apo organizate profesionale, që ofron mundësinë e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në rrugë jashtëgjyqësore, ofruesi duhet të specifikojë karakteristikat dhe kushtet e zbatimit të saj.
4. Informacioni i parashikuar në këtë nen duhet të ofrohet në kohë të mjaftueshme, përpara nënshkrimit të kontratës apo, në mungesë të një kontrate të shkruar, përpara ofrimit të shërbimit.

Neni 15

Komunikimet tregtare nga profesionet e rregulluara

1. Çdo kufizim lidhur me komunikimet tregtare është i ndaluar, përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj. Komunikimet tregtare, nga profesionet e rregulluara, duhet të jenë në përputhje me rregullat profesionale që lidhen, sidomos, me pavarësinë, dinjitetin, integritetin e profesionit dhe me sekretin profesional, në mënyrë që të përputhen me natyrën specifike të çdo profesioni.
2. Rregullat profesionale për komunikimet tregtare duhet të jenë jodiskriminuese dhe të justifikueshme nga një arsye madhore, që lidhet me interesin publik dhe proporcional.

KREU V DISPOZITA TË FUNDIT DHE KALIMTARE

Neni 16 Dispozita kalimtare

Në përputhje me dispozitat e neneve 4 - 9, të këtij ligji, brenda tre vjetëve, nga hyrja në fuqi e tij, duhet të shqyrtohen të gjitha kriteret ekzistuese, të parashikuara nga legjislacioni shqiptar në fuqi, për të përcaktuar përputhshmërinë e tyre me këtë ligj. Metodologjia e shqyrtimit të përputhshmërisë së kriterëve ekzistuese me këtë ligj do të përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave, të nxjerrë në zbatim të këtij ligji. Dispozitat ekzistuese, që nuk përputhen me parashikimet e këtij ligji, duhet të ndryshohen brenda tre vjetëve, nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 17 Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda një muaji, nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të nenit 6, pika 3.
2. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda gjashtë muajve, nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të nenit 10, pika 3.
3. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda tre muajve, nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të nenit 16.

Neni 18 Hyrja në fuqi

1. Ky ligj hyn në fuqi tre muaj pas botimit në “Fletoren zyrtare”.
2. Dispozitat e parashikuara nga kreu III, i këtij ligji, i fillojnë efektet e tyre pesë vjet pas datës së hyrjes në fuqi të këtij ligji.

K R Y E T A R I

ILIR META